



VENDIM

Nr.23 Date 25.03.2009

**MBI RINOVIMIN E LICENSAVE NE AKTIVITETIN E
PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE
SHOQERISE KESH SH.A**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1, germa a dhe d, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, pika 1 germa a dhe g, 13, 14 dhe 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote/te pjesshem dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 25.03.2009, mbasi shqyrtoi kërkesen e shoqerise KESH sh.a per Rinovimin e Liçensave ne Aktivitetin e Prodhimit dhe Tregtimit te Energjise Elektrike

konstatoi se:

- Me vendimin Nr.19, date 09.03.2009, Bordi i Komisionereve vendosi fillimin e procedurave te shqyrtimit te aplikimit per rinovimin e liçensave ne aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit te energjise elektrike per shoqerine “KESH” sh.a.
- Paraqitjen e plote te dokumentacionit nga KESH sh.a siç kerkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote/te pjesshem dhe rinovimit të liçensave”,

Per gjithë sa me sipër Bordi i Komisionereve te ERE-s

VENDOSI :

1. Te rinovojë liçensat ne aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit te energjise elektrike per shoqerine “KESH ” sh.a per nje afat 30 vjeçar per aktivitetin e prodhimit dhe 5 vjet per aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje aplikuesin per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.23 Date 25.03.2009

**MBI RINOVIMIN E LICENSAVE NE AKTIVITETIN E
PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE
SHOQERISE KESH SH.A**

Anetaret e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____